

VENDIM
Nr.782, datë 14.12.2005

PËR LEJIMIN E EKSPOZIMIT TË PIKTURËS “MOTRA TONE”, OBJEKT ME VLERA UNIKALE TË TRASHËGIMISË KULTURORE KOMBËTARE, JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 19 të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, me propozimin e Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e ekspozimit të pikturës “Motra Tone”, objekt me vlera unike të trashëgimisë kulturore kombëtare, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, nga muzeu C2RMF, Luvër, në muzeun D’Orsay, në Paris, Francë, nga datat 14-16 dhjetor 2005.

2. Ekspozimi jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të bëhet, në përputhje me udhëzimin nr.2, datë 18.3.2004 të Këshillit të Ministrave “Për lëvizjen e objekteve të trashëgimisë kulturore të luajtshme, me vlera të veçanta kombëtare dhe unike, për restaurimin, studimin dhe ekspozimin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”.

3. Ngarkohet Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha